



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 395 Akti**

**Nr. 440 Vendimi**  
**Tiranë, më 13.9.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, më 13 shtator 2021, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arben Mullaj**, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni G i Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Germa “a”, e pikës 1 të nenit 64, dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Mullaj ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit

të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**2.** Në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Arben Mullaj, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, pas shpërndarjes së çështjes së tij me short në datën 16.12.2019 në trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Genta Tafa (Bungo).

**3.** Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), i zgjedhur me short me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

**5.** Komisioni, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin e rivlerësimit se ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**6.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të zgjedhur me short në datën 16.12.2019 dhe iu kërkua të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

**7.** Në përgjigje të *e-mail*-it, të dërguar sipas pikës 6 më lart, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

**8.** Pasi relatori i çështjes kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, paraqiti para trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, rezultatet e hetimit dhe i rekomandoi trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Mullaj.

**9.** Në mbledhjen e datës 5.7.2021, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi arriti në përfundimin se provat në lidhje me kriterin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale kanë nivelin e provueshmërisë, me vendimin nr. 2, datë 5.7.2021, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Mullaj, dhe të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**10.** Me anë të postës elektronike<sup>1</sup> subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi mbylljen e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës për të tria kriteret, për sa rezultonte nga hetimi. Në po të njëjtin *e-mail*, subjektit të rivlerësimit iu bënë me dije të drejtat që gëzon sipas ligjit për: (i) njohjen me dokumentet e dosjes dhe marrjen kopje të tyre menjëherë pas marrjes së njoftimit; (ii) të drejtën për të thirrur dëshmitar apo marrjen e çdo prove mbështetëse; (iii) të drejtën për të paraqitur shpjegime apo prova me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, jo më vonë se 21.07. 2021. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i, subjektit të rivlerësimit iu dërguan rezultatet e hetimit .

---

<sup>1</sup> *E-mail*, datë 06.07.2021, ora 17.37 .

**11.** Në datën 13.7.2021, subjekti i rivlerësimit u njoh me dokumentacion fizik dhe elektronik të dosjes së hetimit kryesisht. Subjekti pas marrjes së dokumentacionit deklaroi se: (i) u njoh dhe mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar në *CD* dhe/apo në formë shkresore (fotokopje) sipas kërkesës së tij; (ii) nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr në Komision; dhe (iii) ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që i është vënë në dispozicion sipas inventarit përkatës bashkëlidhur kësaj deklaratë.

**12.** Me anë të emailit të datës 15.7.2021, ora 21.23, subjekti ka njoftuar Komisionin në lidhje me kërkesën për dorëheqje nga statusi i magjistratit e dorëzuar nga ana tij pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe kërkon pezullimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes.

**13.** Në datën 28.7.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., njoftoi Komisionin se në seancën plenare të datës 22.7.2021 ka vendosur të miratojë kërkesën për dorëheqje të z. Arben Mullaj, duke deklaruar mbarimin e statusit të subjektit të rivlerësimit si magjistrat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bashkëlidhur kësaj shkrese KLGJ-ja ka dërguar kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.7.2021.

**14.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2021, Këshilli Lartë Gjyqësor ka vendosur: (i) deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Arben Mullaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status; (ii) efektet e këtij urdhërimi fillojnë në datën 31.8.2021; (iii) përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit Arben Mullaj nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iv) një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit Arben Mullaj sipas kërkesave të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve; (v) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

**15.** Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2021, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Mullaj, nuk ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 22.07.2021, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”.

**16.** Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, më 7.9.2021 ka njoftuar subjektin, nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G, paragrafi 1 dhe 2 i Aneksit të Kushtetutës.

**17.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 09.09.2021, me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

## **II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**18.** Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Arben Mullaj, ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

**19.** Në germën “a”, pika 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

**20.** Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

*“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.*

*2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”*

**21.** Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

**22.** Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*

*2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.*

**23.** Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

*“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

**24.** Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, më datë 07.09.2021 ka njoftuar subjektin, nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G, paragrafi 1 dhe 2 i Aneksit të Kushtetutës.

**25.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 9.9.2021 me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

**26.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara për sa më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- ii. Sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës subjekti i rivlerësimit, z. Arben Mullaj, ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen;
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.07.2021 ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit Arben Mullaj.
- iv. Vendimi nr. \*\*\*, datë 22.07.2021 i KLGJ-së nuk është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit.
- v. Subjekti konfirmon vullnetin e tij për të mos marrë pjesë dhe për të mos u dëgjuar në seancë dëgjimore.

**27.** Trupi gjykues i Komisionit çmon se referuar fakteve të evidentuara me lart, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Mullaj, duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**28.** Trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësi *ex officio*, në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, kur shprehet: *“Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”*

**29.** Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

**30.** Ky është një qëndrim i unifikuar edhe i Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimmarrje të mëparshme, sipas së cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Mullaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Arben Mullaj si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 13.9.2021

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Relatore**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*